



Reforma Derregullatore, Ulje e Burokracisë për Bizneset

Që në mbledhjen e parë të Këshillit të Investimeve u diskutua Bashkimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit - si pjesë e rëndësishme e reformës derregullatore që ka ndërmarrë Qeveria në kuadrin e përmirësimit të klimës së biznesit në vend. Objekti kryesor - lehtësimi i procedurave dhe ulja e burokracive për bizneset. Kjo reformë fokusohet tek:

- 1) reforma e autorizimeve të lëshuara nga Ministrinë dhe institucionet e varësisë (përfunduar në Mars 2015)
- 2) reforma e licencave dhe lejeve dhe krijimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit. Kjo e fundit u krijua me Ligjin Nr. 131/2015 i cili shkrin në një institucion të vetëm Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrën Kombëtare të Licencimit.

Përfitimet e QKB-së:

- Krijimi i një qendre që ofron një ndalesë të vetme për aplikimet e regjistrimit dhe licencimit.
- Sigurimi i aksesit të unifikuar për publikun lidhur me procedurat e regjistrimit dhe licencimit.
- Reduktimi i kostove administrative në masën 14 milionë lekë; Analiza e plotë strukturore do të bëhet nga GIZ.

vijon ne faqe 2

Këshilli i Investimeve, Urë Lidhëse Qeveri-Biznes

Këshilli i Investimeve u krijua më 15 Prill 2015, me synim lehtësimin e një dialogu konstruktiv dhe shkëmbim të pikëpamjeve midis qeverisë dhe sektorit privat në fushën e klimës së investimeve dhe antikorrupsionit. Një platformë e re e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH-it.

“Këshilli i Investimeve është një krijesë e re, jo për të shtuar një mekanizëm më shumë në këtë proces ndërveprimi, por për të krijuar një mekanizëm, i cili falë mbështetjes dhe ekspertizës së BERZH-it do të na japë mundësinë të adresojmë drejtpërdrejtë problemet e sipërmarrjes dhe të kërkojmë sëbashku zgjidhjet, për të lehtësuar në vijimësi procesin e të investuarit në vendin tonë”, u shpreh Kryeministri Edi Rama në ceremoninë e organizuar për krijimin e Këshillit të Investimeve.

Puna e Këshillit mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit. Mbështetja financiare fillestare (tre vjeçare) për Sekretariatin është ofruar nga BERZH-i me mbështetjen e Qeverisë Italiane.

Z.Holger Muent, Drejtor i BERZH-it për Ballkanin Perëndimor, deklaroi se *“Përmirësimi i klimës së biznesit është tashmë në fokus të axhendës ekonomike të qeverisë. BERZH-i ka mbështetur Shqipërinë në ngritjen e Këshillit të Investimeve, për të krijuar një platformë për dialogun e sektorit publik-privat dhe për të përmirësuar klimën e investimeve”.*



Falimentimi - projektligji i ri, biznesi po pret

Një çështje mjaft e rëndësishme për biznesin mbetet problematika e falimentimit. Anëtarët e Këshillit të Investimeve, pasi dëgjuan prezantimin e draftit të ri të hartuar me ndihmën e IFC-së, si edhe procesin intensiv

të konsultimeve, filluar më shumë se një vit më parë (rreth 37 tryeza të rrumbullakëta diskutimi, 6 drafte të diskutuara, etj përfshirë edhe një relacion mbi risitë e draftit të propozuar), i kërkuar Qeverisë një angazhim sa më konstruktiv për të përfunduar sa më parë me versionin final të draft-ligjit "Mbi Falimentimin". Ky i fundit konsiderohet si element i rëndësishëm edhe në kuadrin e strategjisë për zgjidhjen e problematikës mbi nivelin e lartë të kredive të këqija në vend.

Sekretariati në kuadrin e punës për monitorimin e rekomandimeve të Këshillit të Investimeve, po ndjek nga afër dinamikën e miratimit të draft-ligjit "Mbi Falimentimin"

vijon nga faqe 1

Reforma Derregullatore, ulje e Burokracisë per Bizneset

- Mundësi reduktimi të shpenzimeve korrente për sportelet e rretheve nga reforma territoriale.
- Krijimi i një qendre të vetme për informimin e biznesit lidhur me regjistrimin dhe licencimin apo zgjerimin e gamës së shërbimeve që do të ofrohen online.

Anëtarët e Këshillit të Investimeve duke inkurajuar dhe mbështetur reformën e derregullimit i propozuan Qeverisë që të tregohet kujdes në hapat që po ndërmerren, të informohet biznesi në kohë dhe të konsiderohen veçoritë e sektorëve të caktuar në këtë proces, pasi kjo është një reformë strategjike për biznesin.


Kontrolli Tatimor, Bizneset kërkojnë Qartësi dhe Procedura të Thjeshta

Në mbledhjen e parë të Këshillit të Investimeve (1 korrik 2015), Inspektimi Tatimor u votua si një nga problemet më të mëdha për klimën e të bërit biznes në Shqipëri. Administrimi i duhur i sistemit tatimor mbetet çelësi i suksesit për financat publike dhe stabilitetin makroekonomik të vendit. Gjithashtu, ai krijon një bazë të fortë për tërheqjen e investimeve, nxitjen e biznesit dhe si rrjedhojë dhe për rritjen ekonomike. Procedurat efektive në administratën tatimore, të cilat sigurojnë transparencë dhe paanshmëri në marrëdhëniet midis enteve shtetërore dhe subjekteve private, krijojnë bazën për funksionimin e suksesshëm të sistemit fiskal.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve realizoi një anketë me biznese që ushtrojnë aktivitet në vend për të evidentuar qartë problematikat që ata ndeshin me administratën tatimore dhe procedurat tatimore në përgjithësi. Anketa u plotësuar nga 110 biznese, ku 78% e të anketuarve ishin shoqëri të mesme dhe të mëdha, ndërsa rreth 22% ishin me pronësi të huaj. Sektorët më të përfaqësuar në anketim ishin shërbimet (32%), hotelet dhe agjencitë turistike (24%), industria (22%) dhe tregtia (15%). Sipas anketës, Tatimpaguesit VIP janë bizneset më të audituara nga administrata tatimore. Bizneset e konsiderojnë të tepërt numrin, shpeshtësinë e kontrolleve tatimore dhe kontaktin direkt me inspektorin. Bizneset janë të shqetësuara në lidhje me shpeshtësinë e kontrolleve, të perceptuara nga ato si një mjet i administratës tatimore për të përmbushur planin e të

ardhurave në buxhet. 25% e kompanive të mëdha që janë përgjigjur në Anketë, pretendojnë të kenë patur të gjitha llojet e kontrolleve për 2013-2015, që i takon nga tre në katër kontrolle. Gjithashtu, komente si "tatimpaguesit më të rregullt janë ata që kontrollohen më së shumti dhe që ndëshkohen më tepër u kanë mbërritur nëpërmjet kësaj ankete.


Natyra e Kontrollit Tatimor në Biznesin e Madh



Deri më sot, ka një perceptim të përgjithshëm nga bizneset që kontrolli/inspektimi tatimor nuk kryhet në bazë të faktorëve të

riskut, por synohet vetëm të lëshohen gjoba dhe të mblidhen të ardhura shtesë në buxhet për të arritur planin ashtu si dhe për t'u bërë presion bizneseve për t'u paguar rryshfet zyrtarit të tatimeve.


Kohëzgjatja e kontrollit të fundit në Biznesin e Madh



Legjislacioni tatimor në përgjithësi perceptohet, kryesisht nga bizneset e mesme dhe të vogla, si shumë i vështirë për t'u zbatuar. Rreth 56% e shoqërive të mëdha që iu përgjigjën Anketës mendojnë se zbatimi i duhur ligjeve ka të bëjë me qartësinë dhe interpretimin e legjislacionit. Prandaj, thjeshtësimi apo unifikimi i sistemit tatimor dhe i legjislacionit në tërësi është i domosdoshëm për të nxitur përmirësime të mëtejshme. Ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor tatimor nuk i ndihmojnë bizneset në konsolidimin e qasjes së tyre të saktë ndaj sistemit tatimor.

Një pakënaqësi të madhe kanë bizneset edhe ndaj Apelitit Tatimor. Ai që ka apeluar më së shumti është biznesi i madh. Anketa eidenton një nivel shumë të lartë pakënaqësie të bizneseve në lidhje me këtë proces. 90% e bizneseve kanë pohuar se apelimi tatimor është disi apo jo-efektiv. Procedurat e apelitit janë burokratike dhe jo-fleksibël për shkak se tatimpaguesit janë të detyruar të parapagojnë shumën totale të detyrimeve tatimore.


Opinioni i sipërmarrjeve mbi arsyet që lidhen me zbatimin e duhur të legjislacionit tatimor



Biznesi ka eidentuar gjithashtu edhe 3 faktorët kryesorë që çojnë në evazion fiskal.

TVSH-ja është faktori i parë më i rëndësishëm sipas përgjigjeve që çon në aktivitet informal. Legjislacioni Tatimor është vlerësuar si faktori i dytë më i rëndësishëm; Marrëdhëniet me Administratën Tatimore si faktori i tretë më i rëndësishëm.

Perceptim i Biznesit mbi Faktorët më të rëndësishëm që çojnë në Aktivitet Informal Fiskal



INFORMALITETI

Sfidë e Përbashkët, Qeveri-Biznes



Që në fillimin e punë së tij, Sekretariati propozoi një axhendë pune për Këshillin, bazuar në eidentimin e problemeve më të mprehta, të votuara nga biznesi. Sfidë e përbashkët e Informalitetit dhe mënyrat për ta luftuar atë ishin e votuar në masën mbi 70% nga bizneset dhe që u diskutua në Mbledhjen e III-të të Këshillit. Kryetari Këshillit të Investimeve, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, z. Arben Ahmetaj theksoi se debati për Informalitetin është një nga debatet më intensive dhe shumë i shëndetshëm në favor të biznesit dhe qytetarëve.

“Është e drejtë që nevojitet një platformë dhe strategji afatgjatë që të jetë e trashëgueshme dhe me rotacionet e pushtetit. Modeli i ri i riskut është një revolucion në mendësinë e institucionit të tatimeve. Ka vetëm dy muaj që funksion dhe është një përpjekje e sinqertë për ta vënë në shërbim të klimës së biznesit dhe jo vetëm të të ardhurave në buxhet”, tha Ministri Ahmetaj.

INFORMALITETI

Sfidë e Përbashkët, Qeveri-Biznes

Z. Peter Sanfey, Drejtor i Departamentit për Çështje Vendore dhe Ekonomike pranë BERZH Londër tërhoqi vëmendjen se Informaliteti nuk është problem vetëm në Shqipëri por në të gjitha ekonomitë e tregut. *“Nevojitet një platformë e qartë qeveritare me afate kohore dhe objektiva të matshëm me përfshirjen e të gjithë aktorëve”,* tha Z.Sanfey. Duke vlerësuar analizën e përgatitur nga Sekretariati ai sugjeroi studime të ngjashme në sektorë të tjerë me rekomandime specifike.

Z. Dietlof Mare, Zv/Presidenti i FIAA-s, vlerësoi analizën e Sekretariatit dhe theksoi rëndësinë e thjeshtimit dhe unifikimit të drejtë të ligjeve dhe procedurave për të siguruar zbatimin e drejtë. *“Por është shumë kritik trajnimi dhe edukimi i administratës tatimore ashtu edhe i bizneseve sidomos të vegjël dhe të mesëm për të ndryshuar mendësinë e tyre të operimit të deritanishëm në këtë realitet të ri të formalizimit”,* tha Z.Mare.

Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Znj. Brisida Shehaj tha se janë bërë shumë hapa në aspektet e legjislacionit dhe janë ndërmarrë një numër i madh trajnimesh me tatimorët, megjithë vështirësitë e hasura për shkak të kapaciteteve të kufizuara të Akademisë Fiskale.

“Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve është në proces rishikimit të thellë. Struktura e saj do të jetë totalisht ndryshe dhe do të synojë forcimin e shërbimit të tatimpaguesve. Do të shkrihen strukturat e terrenit në gjithë drejtoritë rajonale të cilat deri më sot kanë qenë inefficente. Këto struktura agresive me biznesin do të zëvendësohen me inspektorë të cilët do të jenë përgjegjës për zonat e tyre të përcaktuara dhe puna e tyre ditore do të jetë informimi i biznesit për të qenë në përputhshmëri me ligjin dhe ndryshimet ligjore”, tha znj. Shehaj. Për të eliminuar arbitraritetin, administrata tatimore do të përfundojë në fund të dhjetorit Projektin M-TAX, që do mundësojë që kontrolli në terren të bëhet nëpërmjet tabletit si deklarimi i kuponit, xhiros, regjistrimi i punonjësve etj.

Zj. Irena Beqiraj, Zv. Ministre e Financave konfirmoi se Qeveria është duke finalizuar Strategjinë 2 vjeçare kundër informalitetit ku synohet thjeshtimi i procedurave tatimore dhe doganore, diskrecion sa më i vogël në interpretim.


Drejtorja e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, Zj. Diana Leka theksoi domosdoshmërinë e konsultimit paraprak të projekt-akteve me impakt për biznesin dhe me konkretisht zbatimin me korrektësi të parashikimeve dhe garancive ligjore për këtë qëllim sipas Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” si një kërkesë e vazhdueshme e biznesit.

Anketa: Sistemi ‘i komplikuar’ Tatimor dhe Aksesit në Kreditim “Nxitesit” kryesorë të Informalitetit

Për të evidentuar problematikat e bizneseve dhe shkaqet që shtynë në informalitet gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2015 nga ana e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve janë kryer një numër i konsiderueshëm takimesh me aktorë të ndryshëm të përfshirë në diskutimet mbi aksionin kundër-informalitetit si shoqëri tregtare, shoqata dhe organizata biznesesh, aktorë të shoqërisë civile, ekspertë të pavarur të ekonomisë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe zyrtarë të administratës fiskale, etj. Qëllimi i takimeve ka qenë për të mbledhur sa më shumë mendime mbi aksionin, shkaqet e informalitetit dhe sugjerime për trajtimin me efektivitet të fenomenit. Gjithashtu, një Anketë anonime mbi informalitetin u përgatit nga Sekretariati dhe u lançua në faqen e KI për të marrë opinione të drejtpërdrejta nga biznesi.

Anketa u plotësua nga 89 biznese online dhe 11 kompani në takimet direkte. Referuar rezultateve të Anketës, takimeve dhe tryezës me përfaqësues të biznesit është arritur të konkludohet në një seri shkaqesh që shikohen si nxitës të informalitetit, por që mund të kthehen njëkohësisht në frenues të fenomenit dhe kontribues në klimën e të bërit biznesit nëse këto tregues përmirësohen. Referuar rezultateve të Anketës, takimeve dhe tryezës me përfaqësues të biznesit është arritur të konkludohet në një seri shkaqesh që shikohen si nxitës të informalitetit. Nga përgjigjet në Ankete bizneset shprehen se ndeshin vështirësi më të mëdha në lidhje me sistemin tatimor (numrin e taksave, barrën fiskale dhe procedurat tatimore) si dhe përsa i përket aksesit në kreditim.


Informaliteti – Faktorë më problematikë për të bërë biznes



Niveli i ulët i rritjes ekonomike, rënia e kërkesës agregate dhe opsioneve për investime atraktive kanë çuar në një tkurrje të financimit të bankave dhe kërkesa më të forta ndaj bizneseve.

Ka një fenomen tjetër që, po konfirmohet edhe nga anketa, që po njih rritje që është kreditimi informal me interesa shumë të larta që po krijojnë një zinxhir borxhesh dhe vështirësi në formalizimin e tyre. Referuar edhe Anketës mbi Informalitetin del se kreditimi i biznesit është shumë i vështirë, me 49% të përgjigjeve dhe për pasojë nuk është e mundur të konsiderohet si një incentivë për formalizim.

Vështirësitë e aksesit në kreditim



Masat ndëshkimore - A janë të duhurat?!

Nga bizneset e përgjigjura në Anketë dhe ato të kontaktuar direkt, ka një miratim mbi nevojën e penalteteve për të reduktuar informalitetin për të luftuar konkurrencën e pandershme. Por, ka edhe një qëndrim pothuajse unanim mbi ashpërsimin jo racional të masave të ndëshkimit, vlerësuar edhe në kushtet kur ka shumë rezerva ndaj cilësisë së Administratës Tatimore dhe Doganore dhe aftësisë për të vendosur drejt. Nga ana tjetër ka shumë pikëpyetje mbi efektivitetin e sistemit të ankimit për përfshirë apelimin tatimor dhe ankimin në rrugët e sistemit gjyqësor. Gjithashtu raportohet se Gjykatat Administrative kanë një paralizim nga mbingarkesa e çështjeve, organika dhe infrastruktura e kufizuar si edhe mungesa e transparencës. Asnjë Gjykatë Administrative e Shkallës së Parë nuk ka faqe zyrtare në internet. Përveç vonësive në gjykim jashtë afatit ligjor 3-mujor, problem mbetet edhe cilësia e gjyqimit ku bizneset ankohen për vendimmarrje të gjykatave në favor të administratës publike.

Fokusi i punës në 2015

AMBICJA

Të sjellim një standard konstruktiv të dialogut qeveri-biznes me fokus në klimën e investimeve. Rritja e besimit nëpërmjet gjithëpërfshirjes dhe vlerësimit paraprak nga palët e interesuara.

NISMA

*-Propozuam 14 ndryshime ligjore
-2 platforma kundër informalitetit në ekonomi dhe kundër informalitetit në bujqësi*

ORGANIZIME

*-2 Mbledhje me "Focus Group" mbi kontrollin tatimor dhe informalitetin
-3 mbledhje të Këshillit të Investimeve
-15 anëtarë, 6 nga biznesi*

PARIMET

*-Transparenca
-Integriteti
-Gjithëpërfshirja
-Mbrotjtja e të drejtave të biznesit*

BIZNESI

-8 letra zyrtare drejtuar institucioneve qeveritare për problematika të biznesit

ANALIZA

*-2 anketa anonime online me 210 pjesëmarrës nga biznesi
-100 takime me aktorë të rëndësishëm*



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe BERZH nëpërmjet Fondit të Bashkëpunimit Teknik Italian



Adresa: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Blv. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2, Tiranë

E-mail: info@investment.com.al Web: www.investment.com.al